



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/95

Datë: 12.03.2021

Procesverbal

i mbledhjes se II (dytë) të rregullt për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2020.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës për vitin 2020 të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteran të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirë të Luftës.
3. Shqyrtimi i kërkesave.
4. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 18.02.2021 duke filluar në ora 13:30, morën pjesë 7 anëtarë të KPF-së, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve materialin e mbledhjes e keni me disa pika shtesë që tani ju kemi ofruar në mbledhje. A keni diçka rreth rendit të ditës.

Alban Krasniqi: Një kërkesë ka qenë nga Sadije Krasniqi qysh kur kemi miratuar buxhetin e Komunës lidhur me disa raste me sëmundje për personat e prekur nga kanceri pra me ju ndihmuar me mjete financiare.

Rahim Morina: Kemi një raport të Komisionit për miniera dhe minerale dhe procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Hashim Vrenezi: Duhet ta kemi një vlerësim nga Drejtoria për Urbanizëm e pastaj ta diskutojmë këtë raport, pra duhet me pas një vlerësim të Drejtorisë.

Alban Krasniqi: Në këtë raport në nuk mund të ndërhyjmë por me diskutu jo.

Filloreta Bytyçi: Unë tani këtë raport e pranova në mbledhje.

Rahim Morina: Kush jeni ta fusim për diskutim këtë raport në mbledhje? Për ishin 3, kundër 4 abstenime s'kishte.

Rahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rahim Morina: Kush jeni për miratim të procesverbalit? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2020.

Rahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës për vitin 2020 të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteran të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirë të Luftës.

Rahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi i kërkesave

Kërkesa nr.02/30 datë: 01.02.2021 e parashtruar nga z. Jaha Morina nga fshati Astrazub.

Rahim Morina: Kjo kërkesë s'është e plotësuar me dokumentacione veç letërnjoftimin e ka.

Alban Krasniqi: Kërkoj që të ardhmen çdo kërkesë ta shqyrtoni para se me sjellë në Komitet, pra të jenë të plotësuara me dokumente.

Filloreta Bytyçi: Me qenë se është i sëmurë nga kanceri kisha kërkuar t'i ndihmojmë.

Rahim Morina: Unë ketë person e njoh mirë vërtet vuan nga kanceri.

Alban Krasniqi: Unë po kërkoj që dokumentet të jenë të kompletuar, kur do që me thirrni unë jam i gatshëm të vijë ta votoj kërkesën.

Rahim Morina: A jeni që të ja ndajmë 900 euro, dhe ne ja kërkojmë parashtruesit të kërkesës dokumentet me kusht që nëse i sjellë dokumentet në juve dërgojmë me email dhe ju njoftojmë? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/33 datë: 05.02.2021 e parashtruar nga Zade Kryeziu nga fshati Mleqan.

Rahim Morina: Me qenë se kërkesa është për mjete financiare për shërim, a jeni që të ja ndajmë 500 euro? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/25 datë:28.01.2021 e parashtruar nga BIK në Malishevë, për sigurimin e parcelës për varreza në Malishevë.

Rahim Morina: Ne kemi një vendim nga asambleja e kaluar që është ndarë një parcela për varreza të qytetit, drejtorisë për Gjeodezi me kanë thënë se nuk është i specifikuar vendi, pra duhet të jenë pikat përkufizuese.

Alban Krasniqi: Drejtoria për Gjeodezi duhet të bëjë përcaktimin e lokacionit.

Rahim Morina: Atëherë po e shtyjmë kërkesën për një mbledhje tjetër deri sa të kemi informacione shtesë.

Kemi një raport për inspektimin e Ndërmarrjeve me Licenca dhe leje në territorin e Komunës së Malishevës, raport i Komisionit për miniera dhe minerale.

Kërkesa nr.02/79 datë: 01.02.2021 e parashtruar nga z. Sefer Krasniqi nga fshati Damanek për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike.

Alban Krasniqi: Është e çuditshme që sa lehtë palët i marrin certifikatat në Drejtori e ne me kërkuar një dokument nuk na sigurojnë.

Rahim Morina: Me qenë se Ligji për dhënien në shfrytëzim kërkoj që kryetari duhet meju drejtuar asamblesë, a jeni që ta përcjellim ketë kërkesë për zyrën e kryetarit të Komunës? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/24 datë: 27.01.2021 e parashtruar nga z.Labinot Krasniqi nga fshati Bubavec, për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike.

Rahim Morina: A jeni që ta përcjellim edhe ketë kërkesë për zyrën e kryetarit të Komunës? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/28 datë: 29.01.2021 e parashtruar nga shefi i Grupit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës të listës "GUXO" Vjosa Osmani.

Valon Krasniqi: Ne tash jeni grup brenda asamblesë sepse tash jemi 3 anëtar dhe po besoj që na takon një zyre.

Alban Krasniqi: Ne në fillim kemi thënë që grupet që janë të përfaqësuara në kuvend e që tash kjo listë është grup dhe jam që kjo kërkesë të trajtohet në kuvend, sepse tash renditja ka ndryshuar.

Muharrem Morina: Ligji si njeh grupet e ju me rregullore i keni tash të rregulluara.

Rahim Morina: Lidhur me atë zyre Ldk ka kërkuar që ne ta lirojmë atë zyre, por ata se kanë kuptuar se ne tash ne jemi grup aty.

Hashim Vrenezi: Nëse nuk hidhet si kërkesë në votim unë s'jam as me diskutuar kërkesën dhe mos i kaloni disa gjëra në mënyrë të heshtur. Ma shëni ka pas kërkuar Kastrioti bile edhe në Mapl sqarim se një anëtar në kuadër të grupit pas zgjedhjeve si të vendoset kjo.

Alban Krasniqi: Kjo ska bazë si qëndrim i juaji pasi që për një praktikë me përdorë votën kjo është e ulët, mos të dalim prej kulturës parlamentare.

Halil Morina: E kërkoja fjalën disa herë, lidhur me këtë çështje kur i kemi themeluar komitetet na thojshit veç sa i keni marrë në zgjedhje e jo pas zgjedhjeve që ishim 13 anëtar në subjektin tonë.

Filloreta Bytyçi: Kjo ka qenë e rregulluar por në këtë mandat se keni zbatuar Ligjin.

Rahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Për ishin 3, kundër 2, abstenime 2.

5. Të ndryshme.

Rahim Morina: Ju përsëritet të gjithëve

Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:20

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

